



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-4692/2022
Kaçanik, 18.II.2022

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë anëtar i Komisionit Vlerësues për Projektpropozimet e OJQ-ve

Komuna e Kaçanikut, sipas Thirrjes publike Nr. 01 Nr.104/02-4403/22 të 15. 2.2022, për aplikim për subvencione për vitin 2022 në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, planifikon të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave joqeveritare në fushat prioritare që ndërlidhen me veprimtaritë, si:

- Mbeshtetja, nxitja, fuqizimi, zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve të përgjithshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
- Organizimi i ngjarjeve me karakter bashkëpunimi për promovimin e vlerave në fushat e kulturës rinisë dhe sportit;
- Përfshirja e të rinjve në aktivitetet kulturore, rinore e sportive.

Përkatësisht:

- Promovimi, ruajtja dhe kultivimi i vlerave tradicionale, gjithnjë duke u bazuar në planprogramin vjetor për vitin 2022, si dhe në politikat programore të Sektorit për Kulturë për organizimin e festivaleve, koncerteve dhe shënimin e datave kulturo-historike etj.
- Promovimi, zhvillimi dhe masivizimi i sportit, bazuar në plan-programin e aktiviteteve (garave) për vitin 2022, si dhe në politikat programore të Sektorit për Rini e Sport - zhvillimi dhe masivizimi i sportit, përkrahja e klubeve sportive, fuqizimi i rinisë, mbështetja e përfshirjes dhe organizimit të ngjarjeve promovuese dhe rekreative etj.
- Promovimi i të drejtave të fëmijëve, puna vullnetare, bazuar në plan-programin vjetor për vitin 2022.

Rregullorja e MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 8, paragrafi 3.2, parsheh që anëtar i çdo komisioni vlerësues për projekt-propozimet e OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë edhe dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve. Për këtë qëllim, Komuna e Kaçanikut fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë anëtarë të regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët, sipas nevojës së institucionit, do të caktohen në cilësinë e anëtarëve të komisioneve vlerësuese për projekt-propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi, kanë:

- Të punësuarit në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertët e pavarur, të cilët kanë të paktën 2 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo me fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 2 (dy) vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civilë apo pozitash të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet deri më 7.III.2022, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5).

Komuna e Kaçanikut, do t'i vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrjeje publike do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës do të ftohen për të qenë anëtarë të komisioneve vlerësuese, bazuar në thirrjet publike që do të bëjë Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2022.

Me respekt,

Kryetari i Komunës,
z. Besim Ilazi

